



Jam sëmurë

Ku të mjekohem?

Si ta di se ku duhet të shkoj?

Listën e institucioneve dhe të profesionistëve të shëndetësisë pranë banesës sime mund ta gjej në <http://annuaire.sante.ameli.fr>



Tek një profesionist i shëndetësisë jashtë spitalit

Për çdo problem shëndetësor, mund të vizitoheni te një mjek "i përgjithshëm" që do t'ju ekzaminojë dhe do t'ju japë recetë për barnat për të cilat keni nevojë. Nëse keni nevojë për ekzaminime ose kurime plotësuese, ai ju orienton drejt një mjeku "specialist" ose te një ndihmësmjek (infirmier, masazhator fizioterapist,...).



Në farmaci

Për të blerë barnat, me ose pa recetë të mjekut ose të spitalit.
Për të kërkuar këshilla.

Barnat me pagesë mund të mbulohen nga sigurimi juaj shëndetësor: shihni faqen 2 për përçapjet që duhen kryer për të bërë kërkesën.



Në spital

Në rast urgjence

Për disa ekzaminime ose konsulta me specialistë, duke lënë takim.



Në struktura ku mjekoheni falas cilado qoftë situata juaj

Për të gjitha mjekimet, në qendrat e kujdesit shëndetësor (PASS)

Për gratë shtatzëna dhe fëmijët nën 6 vjeç:
në qendrat e mbrojtjes së nënës dhe fëmijës PMI

Për tuberkulozën: në qendrën e luftës kundër tuberkulozës (CLAT)

Për depistimin e HIV, hepatiteve dhe IST: në CeGIDD

Për marrjen e mjeteve kontraceptive: në qendrën e planifikimit familjar (CPEF)

Për varësitë (nga droga): në CSAPA

Në shoqatat e specializuara.



Në rast urgjence mjekësore, telefonoj në numrin 15 ose 112 që do të më udhëzojë sipas gjendjes sime.

Vini re

Mos-diskriminimi dhe sekretet mjekësore : Profesionistët e shëndetësisë (mjekët, infirmierët, dentistët, etj.) nuk mund të refuzojnë t'ju mjekojnë për shkak të origjinës suaj. Gjithashtu atyre u ndalohe të transmetojnë informacione mbi gjendjen tuaj shëndetësore kujt do personi tjetër, madje as autoriteteve.

Mjeku kurues: për t'u mjekuar dhe rimbursuar më mirë, duhet të zgjidhni një mjek që do të ndjekë vijimin e gjendjes tuaj mjekësore. Diskutoni për këtë gjatë konsultës suaj të parë.

Asnjë ndërhyrje mjekësore dhe asnjë kurim nuk mund të kryhen pa marrë paraprakisht një informacion të plotë dhe pa pëlqimin tuaj.

Si mund të merret një sigurim shëndetësor për të marrë përsipër shërbimet tuaja mjekësore?

Në Francë, shërbimet mjekësore janë me pagesë por **ju mund të përfitoni një sigurim shëndetësor i cili do të marrë përsipër një pjesë ose tërësinë e shpenzimeve tuaja shëndetësore dhe ato të familjes suaj**, sipas situatës në të cilën ndodheni. **Kërkoni informacionet dhe formularët pranë CPAM** (fondi primar i sigurimeve shëndetësore të qytetit ku jetoni) ose me telefon në 3646 (numër me pagesë) gjithashtu dhe në faqet www.ameli.fr dhe www.complementaire-sante-solidaire.gouv.fr

- E RËNDËSISHME**
- ✓ **Nëse fëmijët tuaj kanë nevojë për mjekime** : edhe nëse ju nuk e keni bërë akoma kërkesën ose nëse ajo është duke u shqyrtuar, ju i bëni kërkesën CPAM duke plotësuar formularët dhe duke bashkëngjitur dokumentat e duhura si dhe faturat e shërbimeve mjekësore në mënyrë që ato të merren menjëherë përsipër.
 - ✓ **Ju duhet të jepni një adresë fikse** apo t'i kërkoni shumë shpejt një organizmi (psh : CCAS) një adresë ku mund të tërhiqni postën nëse jeni pa banesë stabël.

Ju keni një leje qëndrimi. Në mënyrë që shërbimet mjekësore t'ju merren përsipër, ju duhet të merrni 2 sigurime :

1) Marrja e sigurimit shëndetësor :

Ai ju lejon t'ju rimbursohen një pjesë e shpenzimeve tuaja shëndetësore. Ju i kërkoni formularin CPAM dhe bashkëngjisni dokumentat që ju kërkohen. Pasi të jetë pranuar kërkesa juaj, ju do të merrni një letër e quajtur « vërtetimi i të drejtave », dhe më pas një kartë « kartë Vitale », të cilën ju duhet ta paraqisni tek mjeku, në spital, në farmaci, etj. në mënyrë që të rimbursoheni.

2) Marrja e sigurimit shtesë :

Ai ju lejon që të rimbursoheni më mirë, ose totalisht ose pjesërisht sipas **nivelit të të ardhurave tuaja apo sipas kontratës që keni zgjedhur.**

- **Nëse keni të ardhura të pakta** : ju mund të përfitoni falas **Sigurimin solidar të shëndetit (C2S)**, pa asnjë lloj pagese financiare nga ana juaj. Ju nuk duhet të paguani shërbimet mjekësore tek mjeku, në spital, në farmaci..., ato do të merren përsipër menjëherë. Kërkoni formularin pranë CPAM nga i cili vareni.
- **Nëse të ardhurat tuaja janë pak të larta** : ju **gjithashtu** mund të përfitoni **C2S**, nëse paguani një pjesë financiare e cila varet nga mosha juaj. Sigurimi mbetet i njëjtë nëse paguani apo jo pjesën financiare. Kërkoni formularin pranë CPAM nga i cili vareni.
- **Nëse të ardhurat tuaja janë shumë të larta** për të përfituar **C2S** : ju mund të merrni një sigurim shtesë me pagesë në mënyrë që shërbimet tuaja mjekësore të rimbursohen më mirë. Interesohuni direkt tek sigurimet shtesë.

Unë jam refugjat / nxënës/ pjesëtar i familjes së një personi në Francë i cili ka sigurimin shëndetësor :	Unë marr një ndihmë familjare apo sociale (RSA, pagesë familjare, ndihmë për strehimin, AAH...):	Unë kam një punë në Francë :	Unë gjendem në një situatë tjetër :
Unë mund të përfitoj sigurimin shëndetësor që prej arritjes sime në Francë. Unë bëj kërkesën pranë CPAM nga varem pa pritur 3 muaj prezence në Francë.	Unë mund të përfitoj sigurimin shëndetësor që prej arritjes sime në Francë. Unë bëj kërkesën pranë CPAM nga varem pa pritur 3 muaj prezence në Francë.	Unë sigurohem që në fillim të punësimit tim. Unë bëj kërkesën pranë CPAM nga varem pa pritur 3 muaj prezence në Francë.	Unë duket të qëndroj më shumë se 3 muaj në Francë para se të bëj kërkesën pranë CPAM nga varem. Duhet ti bashkëngjis dosjes sime vërtetimet e vendbanimit.

Për të bërë dosjen tuaj të sigurimit shëndetësor pranë CPAM (ju do të mbani një kopje të saj) :

- ✓ Ju shënoni tek formularët gjithë personat të cilët varen nga ju dhe që jetojnë në Francë në mënyrë që dhe ato të sigurohen.
- ✓ Ju dorëzoni të gjitha provat e prezencës suaj në Francë për më shumë se 3 muaj, nëse është e nevojshme, me emrin tuaj dhe datën (për shembull : vërtetim pagese qeraje, fatura telefoni, receta të një mjeku, vërtetimin e ndonjë shoqate...).
- ✓ Ju bashkëngjisni faturat e shërbimeve mjekësore nëse keni në mënyrë që dosja juaj të shqyrtohet me përparësi dhe nëse është e mundur shpenzimet e bëra t'ju rimbursohen.

